

**RAPORT**

**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**


**Për programin e studimit**

**Master i Shkencave në “E drejtë penale”, ofruar nga Kolegji**

**Universitar “I Biznesit”**

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Luan Veliqoti
2. Prof. Asoc. Dr. Engjëll Likmeta



Tetor 2018



## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "I Biznesit"
2	Fakulteti që e ofron:	Fakulteti i Drejtësisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër MASH Nr. 482, datë 03.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VKM Nr. 651, datë 14.09.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "E drejtë penale"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve për programin e studimit: 2016-2017 2017-2018	8 studentë 18 studentë

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”

Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” i Kolegjit Universitar “I Biznesit” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë, përkatësisht nga Departamenti i së Drejtës Penale.


Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB), ka filluar veprimtarinë e tij në sistemin e arsimit të lartë si “Akademika Profesionale e Biznesit” me VKM Nr. 651, dt. 14.09.2011. Institucioni është akredituar me Urdhër Nr. 557, datë 16.11.2012 dhe riakredituar me VBA Nr. 100, datë 10.11.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike. Me Urdhër të MASR Nr. 39, datë 30.01.2018 është miratuar Statuti i Institucionit si Kolegji Universitar “I Biznesit”.

Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është hapur në përputhje me kërkesat e tregut të punës, me një kurrikul të bazuar në nevojën për konsulentë juridike dhe veprimtari praktike profesionale në fushën penale, me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 545, datë 13.11.2012, në bazë të Vendimit Nr. 394, dt. 26.10.2012 të Këshillit të Akreditimit, si program studimi i ciklittë dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale”, pranë Fakultetit të Drejtësisë. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 6, datë 06.01.2016, është bërë regjistrimi i formës së diplomës. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Asoc. Dr. Luan Veliqoti
2. Prof. Asoc. Dr. Engjëll Likmeta



Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Znj. Ersi Dako.

Më datë 17.10.2018, Institucioni është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 18.10.2018, përmes AMS dhe shkresës zyrtare Nr. 455 Prot., datë 18.10.2018, Institucioni përcjell komentet në lidhje me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duke shprehur dakordësinë e tij me Draft-Raportin. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

# ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

## I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit:

- a) Të pasurohet fondi i bibliotekës me periodikë të ndryshëm në fushën e drejtësisë.
- b) Të ristrukturohet Plani mësimor, ku të përcaktohet jo vetëm ngarkesa e studentit në auditor (leksione-seminare), por edhe ajo jashtë auditorit.
- c) Të realizohen nga personeli akademik Konferenca Shkencore, të cilat duhet të përfshijnë edhe institucione të tjera profesionale e akademike në fushën penale.
- d) Të realizohet një auditium i programuar dhe i plotë nga ana e Institucionit.
- e) Të formatohen të gjitha syllabuset e këtij program studimi, sipas një strukture të caktuar, e cila duhet të përmbajë të gjitha elementët e nevojshëm që kërkon një syllabus.
- f) Të sigurohet që studentët e këtij program studimi të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni:

- a) Për rekomandimin: “Të pasurohet fondi i bibliotekës me priodikë të ndryshëm në fushën e drejtësisë”, Institucioni, ka bërë përmirësime të mira, në bibliotekë ndodhen revista periodike të fushës së drejtësisë, si: Tribuna Juridike, Jeta Juridike, Illyrus, Avokatia, Mjekësia Ligjore etj. Përveç këryre revistave, Institucioni disponon edhe një bilbiotekë on-line të aksesueshmenga pedagogët dhe studentët me adresat respektive.
- b) Për rekomandimin: “Të ristrukturohet Plani mësimor, ku të përcaktohet jo vetëm ngarkesa e studentit në auditor (leksione-seminare), por edhe jashtë auditorit”, Institucioni karistrukturuar Planin mësimor, ku është përcaktuar qartë ngarkesa e studentit jo vetëm në auditor por edhe jashtë tij.
- c) Për rekomandimin: “Të realizohen nga personeli akademik konferenca shkencore, të cilat duhet të përfshijnë edhe institucione të tjera profesionale dhe akademike në fushën penale, institucionika organizuar konferenca shkencore siç mund të përmenden: Konferenca e IV Shkencore Ndërkombëtare me temë, “*Reforms in economy and Justice, conditions and chellange for Albania European Perspective*”, zhvilluar nëdt.22.04.2016, apo Konferenca e V Shkencore Kombëtareme temë, “*Dinamika e të dretjës ekonomike shqiptare nga periudha e Skënderbeut deri në legjislacionin bashkëkohor*”, zhvilluar nëdt.25.05.2018.
- d) Për rekomandimin: “Të realizohet një auditium i programuar dhe i plotë nga ana e Institucionit”, konstatohet se: Institucioni është audituar nga një ekspert kontabël i jashtëm i pavarur, në raportin e të cilit rezulton se veprimtaria dhe pasqyrat financiare të institucionit janë konform legjislacionit që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare. Gjithashtu, është ngritur dhe funksionon Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila kontrollon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e standardeve akademike dhe të procesit te mësimdhënies.
- e) Për rekomandimin: “Të formatohen të gjitha syllabuset e këtij program studimi, sipas një strukture të caktuar, e cila duhet të përmbajë të gjitha elementët e nevojshëm që kërkon një syllabus”, syllabuset e lëndëve janë standardizuar sipas një formati të caktuar dhe përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm dhe nga viti i ri akademik do të

jenëtëformatuara dhe plotësuarasipas elementëve që parashikohen në Shtojcën Nr. 2 të Vendimit Nr. 41, dt.24.01.2018, të Këshillit të Ministrave.

- f) Për rekomandimin: “Të sigurohet që studentët e këtij program studimi të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare”, kjo pikë është rregulluar nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe Institucioni nuk u jep diplomën studentëve (studentit) pa shlyer provimin e gjuhës angleze në nivelin e kërkuar.

**Në përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se rekomandimet e dhëna në Vendimin e Këshillit të Akreditimit në kuadër të akreditimit të parë, janë përmbushur.**

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” ka filluar në vitin akademik 2011-2012. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (fq.9), programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” ka për qëllim të përgatisë jo vetëm specialistë dhe ekspertë, por edhe studiues që të shërbejnë në administratën publike dhe jo publike, qendrore dhe lokale, në organet e prokurorisë e të gjykatës, në shërbimet dhe organet e policisë gjyqësore, në institucionet e arsimit e të kërkimit shkencor dhe në studio ligjore, për të përmbushur përgjegjësitë që lidhen me menaxhimin, organizimin ekzekutiv, kuptimin dhe aplikimin e zgjidhjeve alternative të marrëveshjeve, analizat e çështjeve juridike dhe hartimin e planeve perspektive të zhvillimit. Ky program studimi u siguron studentëve arsimim me dije të thelluara e të kualifikuara shkencore në fushën e së drejtës penale, duke u përqëndruar në fitimin e kompetencave profesionale e metodike në dhënien e konsulencës dhe ekspertizës së thelluar juridike, në lidhje me legjislacionin penal shqiptar dhe atë ndërkombëtar, si dhe për të zhvilluar karrierë e kryer punë të pavarur shkencore në fushën penale.

Programi Master i Shkencave në “E drejtë penale” është ndërtuar mbi bazën e njohurive të përfituara në ciklin e parë Bachelor 3 vjeçar, duke siguruar vijimin dhe thellimin e njohurive në zhvillimin e kompetencave profesionale e metodike, është konceptuar në harmoni me misionin e përgjithshëm të IAL, KUB, me standartet ndërkombëtare, si dhe risitë që synon të sjellë ky IAL.

Nga informacioni i marrë gjatë vizitave në institucion dhe nga RVB, misioni i programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është: mbështetja e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit me specialistë të aftë në fushën penale në strukturat publike e private, ndërsa disa nga objektivat kryesore të këtij programi janë:

- a. Të përgatisë studentë me njohuri të avancuara në fushën e të drejtës penale, në nivelin kombëtar e ndërkombëtar;
- b. T’u sigurojë studentëve njohuri bazë dhe të specializuara për analizimin, kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve që dalin në praktikën penale;
- c. Krijimin e kompetencave profesionale për të zhvilluar karrierën personale në fushën e së drejtës penale;
- d. T’u krijojë aftësi për punë të pavarur shkencore dhe studime të mëtejshme në fushën penale;
- e. Studentët të fitojnë aftësi për punësim në sektorin publik dhe privat, në fushën e së drejtës penale;
- f. Të përgatisë studentë me njohuri bazë të komunikimi me shkrim dhe verbal, si dhe me një etikë profesionale në fushën penale.

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (Rregullorja e programit) dhe (Statuti i KUB) u konstatua se programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, të parashikuara në nenin 3 të Rregullores së programit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “E drejtë penale”.</p> <p>Bazuar në strategjinë e zhvillimit të KUB, afat shkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, hartimi dhe përditësimi i programit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është hartuar sipas nevojave të tregut. Për të realizuar këtë qëllim, sipas RVB, por edhe gjatë vizitës në Institucion, KUB mban lidhje me sektorë të punësimit privat, si studio ligjore, zyra përmbarimi etj. që kanë si drejtim kryesor fushën e së drejtës penale.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është zhvilluar e përshtatur nëpërputhje me zhvillimin ekonomik të vendit të parashikuar në planin strategjik të MAS, ku pjesë e rëndësishme është mbështetja me legjislacionin adekuat, përfshi edhe atë në fushën penale.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, në syllabuset e lëndëve/moduleve, karahas përshtatjes me zhvillimet aktuale demokratike kombëtare e ndërkombëtare, ruan vlerat kombëtare. Në të janë pasqyruar tradita dhe normat ligjore të vendit tonë.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është pjesë integrale e zbatimit të misionit që ka institucioni, me objektivat konkrete për formimin e juristëve në fushën penale, duke u mbështetur në arritjet bashkëkohore, e përditësuar me legjislacionin penal, si dhe në arritjet doktrinale në këtë fushë, duke u dhënë studentëve kompetenca të përgjithshme e të veçanta që lidhen me fushën penale të shoqëruar gjithmonë me zbatimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.</p>

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblodhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

**Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

**Kriteri 1** Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

**Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” përputhet plotësisht me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Përmbajtja e këtij programi studimi është ndërtuar duke respektuar dhe zbatuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në RSH dhe akte të tjera nënligjore.

Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Ky program studimi përkon me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.

**Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

KUB ka një plan strategjik zhvillimi në nivel institucional për periudhën 2015-2025, i miratuar me vendimin të Senatit Akademik Nr. 42, dt.02.02,2016, mbi të cilin është mbështetur zhvillimi i institucionit, ku adresohen zhvillimi dhe misioni, si dhe objektivat afatmesëm dhe afatgjatë në përmirësimin e programeve të studimeve.

KUB i ka kushtuar rëndësi përmirësimit të objektivave dhe rezultateve të mësimdhënies, të të nxënit dhe të vetëzhvillimit, me synim ofrimin e një procesi cilësor për studentët. Për këtë qëllim zbatohet metodologji e qartë vlerësimi, si:

- Vlerësimi i procesit mësimor nëpërmjet formularëve për performancën e pedagogut;
- Vlerësimi i stafit akademik bazuar në aktivitetin e tyre kërkimor shkencor;
- Mobiliteti i stafit akademik por edhe atij administrativ nëpërmjet projekteve të ndryshme Erasmus+, përfitimin e eksperiencave të reja nëpërmjet leksioneve të hapura etj.

KUB në mënyrë periodike merr informacion dhe sugjerime nga ish studentët e diplomuar, përmes rrjetit ALUMNI, nga partnerët bashkëpunues, vendsa e të huaj, për vlerat e programeve të studimit, nevojat e përditësimit të tyre, plotësime dhe ndryshime të mundshme.

Për përmirësimin e mësimdhënies, Institucioni ka sistem të ngritur të kontrollit permanent përmes pyetësorëve periodikë (semestralë) të pedagogëve nga studentët, midis tyre dhe nga Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë (NJSBC).

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Institucioni ofron program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë



vizitës në Institucion, por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” përputhet me misionin dhe objektivat e Institucionit.

2. Misioni i Institucionit është në përputhje me programin e studimit, ndërsa objektivat e këtij program studimi përputhen me kurrikulën dhe me lëndët/ modulet e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”.
3. Misioni dhe objektivat janë hartuar në përputhje me llojin dhe nivelin e këtij program studimi për t’ju dhënë studentëve njohuri të thella teorike e praktike në fushën penale, me synim krijimin e mundësive për punësim dhe karrierë në sektorin publik, por edhe në atë privat.
4. GVJ vlerëson se Kolegji Universitar “I Biznesit” ka një strategji zhvillimi të vlefshme për periudhën 2015-2025, duke përfshirë në të zhvillimin akademik, procesin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor.
5. Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me strategjinë e zhvillimit të KUB.
6. Institucioni, në mënyrë të vazhduar, por edhe periodike, ndjek rezultatet e procesit të mësimdhënies për konsolidimin dhe përmirësimin e mundshëm të tij, me synim ofrimin ndaj studentëve të një shërbimi sa më cilësor.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**

## **2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Drejtësisë është njësi kryesore i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”. Sipas Statutit të KUB (Neni 11), Fakulteti i Drejtësisë bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore si dhe veprimtaritë me karakter profesional dhe krijues në fushën e drejtësisë. Autoriteti drejtues i tij është Dekani.

Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është Departamenti i së Drejtës Penale. Autoriteti drejtues i tij është Përgjegjësi i Departamentit. Sipas Statutit të KUB (Neni 13), Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, që përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura akademike e Fakultetit dhe Departamentit



Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga tre departamente:

1. Departamenti i së Drejtës Civile;
2. Departamenti i së Drejtës Publike;
3. Departamenti i së Drejtës Penale.

Sipas të dhënave të vënë në dispozicion nga Institucioni, Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga 21 anëtarë PAE dhe 18 anëtarë PAK, si vijon:

Departamenti i së Drejtës Civile: 7 PAE dhe 8 PAK;

Departamenti i së Drejtës Publike: 7 PAE dhe 4 PAK;

Departamenti i së Drejtës Penale: 7 PAE dhe 6 PAK.

Personeli akademik PAE i të tre departamenteve të Fakultetit të Drejtësisë të KUB plotëson numrin minimal të kërkuar nga ligji për arsimin e lartë, përfshi edhe atë me grada dhe tituj shkencorë. Ndërsa personeli akademik PAK thuajse të gjithë janë me grada dhe tituj shkencorë, si dhe personalitete profesionale e shkencore në fushat e tyre.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i së Drejtës Penale, për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 13 anëtarë prej të cilëve 7 PAE dhe 6 PAK, me kualifikimin e mëposhtëm:

- PAE: 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc., 3 Dr., 1 Dr. në proces dhe 1 Msc.
- PAK: 1 Prof. Dr., 4 Dr. dhe 1 Mg.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë KUB, konkretisht në Fakultetin e Drejtësisë, në Departamentin e së Drejtës Penale është organizuar që në mënyrë të vazhdueshme të garantojë realizimin e objektivave të këtij programi studimi.  Institucioni KUB, ka dy fakultete: Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti Ekonomik.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
<b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente.	
<b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe	

*Selepa*

*[Signature]*

Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;

**Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.

Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga tre njësi bazë-tre departamente: Departamenti i së Drejtës Publike, Departamenti i së Drejtës Civile dhe Departamenti i së Drejtës Penale.

Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga tre departamentet e mësipërme, me mision dhe objektiva të mirëpërcaktuara.

Departamentet kanë në përbërje 7 anëtarë efektivë, ku së paku 3 janë me gradë ose titull shkencor, përfshi edhe atë penal.

**Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Në takimet me stafin akademik në Institucion dhe bazuar në dokumentacionin përkatës (Statuti, Rregullore e Fakultetit të Drejtësisë, Rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”) u konstatua se Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i së Drejtës Penale janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë për realizimin e këtij programi studimi gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë së tij.

Gjatë takimit me stafin akademik, u parashtruan mënyrat e procesit të rekrutimit të stafit akademik, ku drejtues të Fakultetit dhe posaçërisht të Departamentit të së Drejtës Penale, përfshihen në mënyrë aktive në të. Ky proces u verifikua dhe u konfirmua edhe në dokumentet e administruara nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Ky proces mbështetet në Rregulloren “Mbi marrëdhëniet e punës së personelit”, ku parashikohen dhe procedurat e përzgjedhjes së personelit në KUB.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. KUB organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënljigjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Kjo strukturë është e organizuar dhe funksionon konform Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015.
2. Departamenti i së Drejtës Penale ka 7 anëtarë personel akademik të brendshëm, prej të cilëve janë më shumë se 3 anëtarë me gradë shkencore ose titull akademik, duke plotësuar këkesat ligjore në këtë fushë.
3. Njësia kryesore dhe njësitë bazë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Departamenti i së Drejtës Penale janë të angazhuar dhe të ndërgjegjshëm për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” si dhe përfshihen, organizojnë dhe drejtojnë procesin e rekrutimit të personelit akademik.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga personeli akademik dhe nga personeli administrativ. Personeli akademik përbëhet nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë. Në personelin akademik me kontratë bëjnë pjesë edhe pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Personeli akademik efektiv, përveç veprimtarisë mësimore, kryen edhe angazhime në fusha të tjera, sikurse janë: veprimtari kërkimore-shkencore, veprimtari për zhvillimin e institucionit, veprimtari për këshillim dhe konsultim me studentët, veprimtari administrative etj.

Personeli akademik gëzon liri të plotë akademike mësimore dhe kërkimore shkencore, në përputhje me aktivitetin akademik dhe statusin që ka. Për rekrutimin e tij zbatohen procedura transparente dhe të mbështetura në rregullore, duke u shoqëruar me kontrata pune për secilin prej anëtarëve të stafit. Në këto detyrime kontraktuale mbahen parasysh natyra e lëndës që do të zhvillojë, performanca e njohurive dhe aftësive që do të transmetojë tek studentët.

Numri i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2017-2018 është 11, prej të cilëve 6 janë PAE dhe 5 PAK. Stafi është i kualifikuar e me përvojë në mësimdhënie, është me grada dhe tituj shkencorë, si dhe fusha e kualifikimit të tyre është sipas lëndës që japin. Ndër ta ka një harmonizim të moshës nën të mesme, të mesme dhe mbi të mesme. Ngarkesa mësimore e secilit është sipas udhëzimeve të MASR. Ngarkesa mësimore më e madhe e këtij program studimi mbulohet nga personeli akademik i brendshëm.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat

Për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik i programit përbëhet nga 11 anëtarë, 6 PAE dhe 5 PAK. PAE paraqitet me kualifikimin: 1 Prof., 1 Prof. As., dhe 4 Dr. PAK paraqitet me kualifikimin: 5 Dr. Në aspektin numerik, raporti PAE/PAK është 54.5 % PAE dhe 45.5 % PAK, ndërsa përsa i takon ngarkesës së mësimdhënies, raporti PAE/PAK është 71.7 % PAE dhe 28.3 % PAK.

Për vitet e tjera akademike që prej akreditimit të parë, të dhënat jepen në tabelat 4 dhe 5 të Anekseve.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Këshilli Shkencor i programit të studimit është i ngritur dhe funksionon duke patur si detyrë kryesore hartimin e kurrikulave, propozime për ndryshim kreditesh, plotësimin me kapacitete njerëzore e fizike. Këshilli Shkencor përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, me kualifikim e kërkuar për këtë këshill. Përbërja e Këshillit Shkencor jepet në tabelën 3 të Anekseve.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik i programit përbëhet nga 11 anëtarë, 6 PAE dhe 5 PAK. PAE paraqitet me kualifikimin: 1 Prof., 1 Prof. As., dhe 4 Dr. PAK paraqitet me kualifikimin: 5 Dr.

Stafi akademik që zhvillon mësim në programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” janë të gjithë me kualifikimin akademik të kërkuar për këtë cikël studimi. Gjithashtu konstatohet se profili i stafit akademik të angazhuar në këtë programi studimi përputhet me programin Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”. Staf i akademik i angazhuar me kohë të pjesshme plotëson kriteret e kualifikimit shkencor që kërkon ky lloj program studimi, si dhe është i kualifikuar dhe profesional në fushën që mbulon, duke i dhënë një lidhje më të mirë të teorisë me praktikën në zhvillimin e këtij programi studimi. Të dhënat e detajuara jepen në tabelat 4 dhe 5 të Anekseve.

Të dhënat sipas seksit

Në këtë program studimi, për vitin akademik 2017-2018 janë të angazhuar 11 anëtarë (6 PAE dhe 5 PAK), prej të cilëve janë 7 meshkuj dhe 4 femra, në raportin 63.6 % me 36.4 %.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli akademik efektiv (PAE) sipas moshës paraqitet: në moshën 36-45 paraqiten 3 Dr/PhD; në moshën 56-65 paraqiten 1 Prof., 1 Prof. As dhe 1 Dr/PhD.

Personeli akademik me kontratë (PAK) sipas moshës paraqitet: në moshën 25-35 paraqitet 1 Dr/PhD.; në moshën 46-55 paraqiten 2 Dr/PhD.; në moshën 56-65 paraqitet 1 Dr/PhD dhe në moshën 66-68 paraqitet 1 Dr/PhD. Të dhënat paraqiten në tabelat 6.1 dhe 6.2 të Anekseve.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Stafi akademik dhe personeli administrativ i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Edrejtë penale” në KUB kalojnë nëpër procedurat e rekrutimit, të cilat janë pjesë e statutit dhe e rregulloreve të tjera të miratuara nga Senati Akademik i KUB, në pajtim me Kodin e Punës. Pranimi i personelit sipas nevojave bëhet i hapur, transparent dhe me konkurs nëpërmjet njoftimit në media sociale, si dhe në faqen zyrtare të KUB. Pas pranimi të kërkesave të aplikantëve me dokumentacionin përkatës, bëhet rankimi i kandidatëve potencialë të mundshëm për pranim dhe u caktohet koha për intervistë. Pas intervistave bëhet vlerësimi i secilit kandidat për kriteret e veçanta dhe më pas bëhet përzgjedhja e kandidatit fitues. Kandidati i përzgjedhur nënshkruan kontratën, në të cilën përshkruhen detyrimet, të drejtat e tyre, shpërblymimi financiar, ngarkesa mujore, si dhe kërkesa specifike. Nga verifikimi në Institucion, në zyrën e Burimeve Njerëzore, kontrata e personelit është e detajuar dhe e plotë.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Sipas të dhënave të Institucionit (RVB, fq. 16) personeli administrativ i KUB në mbështetje të procesit mësimor përbëhet nga: Administratori, Sekretaria Mësimore, Zyra e Financës, Biblioteka, Sektori mbështetës, Punonjëse sanitare. Staf i administrativ i KUB ka detyrat e veta të specifikuar në kontrata individuale.

Institucioni nuk ka personel ndihmës mësimor-shkencor, por me shtimin e numrit të studentëve, siç parashikohet në planin strategjik afatgjatë të tij, të shikohet mundësia e shtimit edhe e këtij lloji personeli, në funksion të rritjes së mëtejshme të cilësisë së mësimdhënies.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik dhe administrativ është në përputhje me objektivat e programit të studimit, arritja e të cilave realizohet nëpërmjet programeve të studimit, lëndëve/moduleve dhe syllabuseve të tyre. Në secilin syllabus janë përcaktuar objektivat e çdo lënde, të cilat janë në unitet me objektivat e përgjithshme të programit të studimit.</p> <p>Në funksion të këtyre objektivave rekrutohet edhe Personeli Akademik dhe ai Administrativ, rekrutim i cili kryhet sipas procedurave ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucionit.</p> <p>Veprimtaria e Personelit Akademik dhe Administrativ të institucionit për këtë program studimi, është e anagazhur dhe e bazuar në strategjinë e IAL, KUB, që është: rritja e cilësisë së specialistëve të diplomuar nga njëra anë dhe respektimi i nevojave të tregut nga ana tjetër.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në Fakultetin e Drejtësisë të KUB funksionon Këshilli Shkencor i programit të studimit, i cili ka hartuar kurrikulën e programit të ciklit të dytë Master Shkencor në "E drejtë penale" në marrjen e vendimit të MAS, por edhe në ndjekjen dhe përditësimin e saj. Rol kryesor në këtë drejtim luan Departamenti i së Drejtës Penale për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Për këtë në çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lënde me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.</p>

	<p>Rekrutimi i personelit akademik dhe administrativ realizohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dokumentuara me kontrata të rregullta pune, ku përcaktohen detyrimet dhe të drejtat e tyre dhe janë të përditësuara. Institucioni i jep prioritet rekrutimit në personel akademik edhe nga rradhët e studentëve të diplomuar në KUB me rezultate të larta.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik realizohet konform Statutit dhe Rregulloreve të KUB. Institucioni bën shpalljen publike të njoftimit për punësim në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të KUB. Për këtë qëllim ekziston Rregullorja për rekrutimin e personelit, ku sanksionohen rregullat, kriteret dhe procedurat për punësim. Mbas pranimin të dokumentacionit të aplikantëve, bëhet rankimi i tyre. Më tej me personalin e përzgjedhur kryhet intervista dhe komisioni i posaçëm (ad-hoc) i ngritur me urdhër të Rektorit, paraqet propozimin para Rektorit, i cili i propozon Administratorit emërimin e personelit akademik të përzgjedhur. Rektori i IAL, KUB nënshkuan kontratat e punës me secilin personel akademik të kualifikuar.</p> <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i punësuar me kohë të plotë mbulon 71.7% të ngarkesës mësimore të personelit akademik të angazhuar për realizimin e tij.</p> <p>Njëësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) organizon në mënyrë periodike (2 herë në vit) pyetësorë adresuar studentëve për vlerësimin e pedagogëve, si dhe pyetësorë drejtuar stafit akademik për vlerësimin ndaj institucionit. Pyetësorët përmbajnë indikatorë që përfshijnë tërë procesin e mësimdhënies. Përveç vlerësimit të studentëve, pedagogu vlerësohet edhe nga Dekani i Fakultetit.</p> <p>NJSBC paraqet brenda vitit akademik para Rektori një raport mbi rezultatet e aktivitetit të zhvilluar.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore si përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore disponon një bazë të dhënash, manuale, për rekrutimin e personelit akademik e administrativ, dinamikën e këtij procesi me dokumentacionin konkret, mobilitetin e stafit, si për atë efektiv ashtu edhe për atë të jashtëm.</p>

**Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.**

**Kriteri 1** Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

**Kriteri 2** Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

**Kriteri 3** Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;

**Kriteri 4** Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

**Kriteri 5** Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Përgjegjësi i programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është Dr. Mirgen Prence.

Titullarët e lëndëve/moduleve të programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, janë me të paktën gradën shkencore Dr.

Personeli akademik në këtë program studimi janë lektorë me kontribute të njohura në fushën e mësimdhënies dhe me eksperiencë të profilizuara sipas lëndëve që ata japin.

I gjithë stafi menaxherial i institucionit që ofron këtë program studimi: Rektori, Dekani, Shefat e Departamenteve, koordinatorët e programeve, janë të punësuar me kohë të plotë.

Institucioni siguron personelin e mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore.

Praktika mësimore zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Institucioni ku zhvillohet praktika mësimore, me të cilat institucioni ka marrëveshje paraprake, për të cilat studenti është i orientuar, i jep një vlerësim, i cili vlerësohet nga pedagogu dhe konfirmohet nga Dekani.

Pas përfundimit të praktikës mësimore studenti fiton 10 ECTS, duke u vlerësuar edhe me notë.

**Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.**

**Kriteri 1** Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;

**Kriteri 2** Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

**Kriteri 3** Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.

Udhëheqësi i punës kërkimore të studentit dhe ka kualifikim të orientuar në fushën e Tezës që studenti ka zgjedhur për ta përgatitur.

Udhëheqësi i tezës së studentit ka të paktën gradën shkencore Dr.

Udhëheqësi për temat me karakter kërkimor të aplikuar nuk ka udhëhequr më shumë se 5 studentë dhe nuk ka udhëhequr më shumë se 10 studentë njëherësh në tema që ofrohen nga programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore.



**Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.**

**Kriteri 1** Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Stafi akademik (efektiv apo me kontratë) është i specializuar në fushën kërkimore-shkencore që ofrohet nga ky program studimi. Ata janë me gradën Dr.apo me titullin: Prof. Asoc. ose Prof.

**Kriteri 2** Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Personeli akademik ka kualifikim të lartë në fushën studimore-kërkimore që ofron ky program studimi, i cili gjen pasqyrim në botimin e shumë artikujve shkencorë, monografive apo tekstesh mësimorë. Disa prej tyre janë personalitete shkencore të kësaj fushe.

**Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Personeli administrativ është i angazhuar plotësisht për të ndihmuar dhe kontribuar në realizimin e orëve laboratorike, me dokumentacionin e nevojshëm, me bibliotekën, duke i mirëmbajtur dhe vënë në dispozicion të studentëve dhe procesit mësimor.

**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

I gjithë personeli i institucionit KUB, akademik e administrativ është i angazhuar me detyra konkrete, në funksion të realizimit të objektivave të këtij programi studimor dhe garantimit të cilësisë së mësimdhënies.

Për shkak të numrit relativisht të ulët të burimeve njerëzore, Institucioni nuk ka staf ndihmës mësimor-shkencor.

**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

**Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Gjatë orarit të punës personeli akademik i brendshëm dhe administrativ janë prezent në institucion. Ngarkesa mësimore e personelit akademik është në varësi të lëndës/modulit dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që përcaktojnë standartet e mësimore për këtë nivel të arsimit.

**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimor realizon një ngarkesë mësimore sipas udhëzimit të MASR. Ajo është në kufijt midis 200 dhe 300 orë mësimore në vit, që është në përputhje me aktet nënligjore për aktivitetet dhe standartet mësimore të personelit akademik për këtë nivel të arsimit.

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni disponon dosje për secilin anëtar të personelit akademik, efektiv dhe me kontratë, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Ky informacion administrohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe funksionon në mënyrë manuale.</p> <p>Për çdo semestër, të çdo viti akademik, institucioni, departamenti, disponon listën e personelit akademik dhe administrativ që angazhohet në realizimin e procesit mësimor. Kjo listë është e disponueshme për studentët.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e stafit akademik janë publike. Për to merret informacion nga mediat sociale dhe nga faqja zyrtare e Institucionit. Ato afishohen edhe në tabelën e njoftimeve të Institucionit.</p>
--	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. GVJ konstaton se personeli akademik dhe administrativ i angazhuar në mësimdhënie, detyra dhe aktivitete të tjera të Institucionit, në funksion të studentëve, është i përgatitur profesionalisht dhe me kualifikimin e nevojshëm kërkimor-shkencor për standardet që kërkon një program studimi Master i Shkencave, konkretisht në “E drejtë penale”.
2. Personeli akademik rekrutohet me procedura të rregullta e transparente e konkurruese, çka garanton një cilësi të mirë në procesin e mësimdhënies dhe aktivitete të tjera akademike.
3. Përveç angazhimit në procesin mësimor, stafi akademik angazhohet edhe në aktivitete të tjera, kryesisht në ato me karakter kërkimor-shkencor, si: pjesëmarrje në konferenca shkencore, botime të fushës në revista shkencore etj. Në këtë proces ata janë stimuluar nga Institucioni, kryesisht nëpërmjet lejitimit dhe mos mbajtjes së pagës për kohën e angazhuar.
4. Stafi akademik me kohë të plotë mbulon 71.7 % të ngarkesës mësimore të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
5. Personeli akademik ka kualifikim të lartë në fushën studimore-kërkimore që ofron ky program studimi, i cili gjen pasqyrim në botimin e shumë artikujve shkencorë, monografive apo tekstesh mësimorë. Disa prej tyre janë personalitete shkencore të kësaj fushe.
6. Institucioni siguron personel të mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikqyrjen e praktikave mësimore. Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë, të vitit të dytë dhe është një mundësi për studentët, jo vetë në lidhjen e teorisë me praktikën, por edhe një informacion për tregun e punës.
7. Udhëheqësi i punës kërkimore të studentit ka kualifikim të orientuar në fushën e tezës që studentit ka zgjedhur për ta përgatitur dhe ka së paku gradën shkencore Dr. Organizimi dhe përgatitja e temave të diplomave kryhet në përcaktimin e tezës brenda kurrikulës dhe nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë midis udhëheqësit dhe studentit me qëllim që ato të jenë sa më individuale dhe t'i përgjigjen nevojave të zhvillimit të shoqërisë në fushën penale.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**

#### 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar "I Biznesit" ofron një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha cilket e studimit. Mjediset e tij, të brendshme e të jashtme janë cilësore dhe plotësojnë të gjitha kërkesat e domosdoshme të studentëve, për mësim, studim dhe punë të pavarur. Vendndodhja e Institucionit është në Rr. "Vangjel Noti", Nr.25, Laprakë, Tiranë.

GVJ vizitoi ambjentet e KUB, si: klasat, auditorë, laboratorët, salla studimi, bibliotekën, por edhe hapësira të tjera të përbashkëta të përdorshme nga studentët. Të gjitha këto ambjente konsiderohen të përshtatshme dhe të mira për plotësimin e kërkesave të studentëve. Gjithashtu u konstatua se edhe për stafin akademik dhe atë administrativ kishte ambjente të përshtatshme dhe të pajisur me infrastrukturë për kryerjen e detyrave të tyre funksionale, të procesit mësimor, por edhe për kryerjen e kërkimeve shkencore. Informacion më i plotë jepet në tabelat 7.1, 7.2, 7.3 dhe 7.4 të Anekseve.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

###### Mjediset për Programin e studimit:

- Auditorë/salla mësimi për leksione/seminare, të pajisura me videoprojektorë dhe laptop;
- Mjedise për personelin akademik;
- Mjedise për personelin administrativ;
- Salla për aktivitete promovuese;
- Laborator informatike;
- Mjedise internet-kafe;
- Sallë e dedikuar për Bibliotekën;
- Mjedis për fotokopjime, librari, etj;
- Arkivë/magazinë;
- Shkallë emergjence;
- Ambjent parkimi.

###### Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ Kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qendrat kërkimore

- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka një vendndodhje të përhershme ku ndodhen mjedisi administrativ qendror dhe mjedisi për zhvillimin e procesit mësimor. Adresa e tij është: Rr. "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë, Tiranë.</p> <p>Ambjentet në dispozicion të institucionit janë në bazë të kontratës Nr. 5153 rep. dhe Nr.1711 Kol, dt.11.09.2014 me një afat deri në vitin 2026. Duke filluar nga viti akademik 2017-2018, ato janë në dispozicion edhe për 8 vjet (<i>Aneksi Nr.21 (marrëveshje kontraktuale)</i>).</p> <p>Institucioni e zhvillon programin e studimit në një godinë ku sigurohet manaxhimi efikas dhe kontrolli i vazhdueshëm, me ambiente me gjithë mjetet didaktike e informative për arritjen e standardeve të programit të studimit që ofron.</p> <p>Institucioni KUB ka marrëveshje me studio ligjore, me institucione publike e private, çka garanton realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore cilësore për lëndët/modulet. Për ato që nuk kanë tekste sigurohen leksione të shkruara të disponueshme nga studentët.</p> <p>Në bibliotekën e KUB ka një fond të konsiderueshëm titujsh libra të fushës së jurisprudencës të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit, për veprimtari kërkimore dhe përgatitjen e tezës nga studentët.</p> <p>Në bibliotekë ka botime periodike në lëmin e drejtësisë, si revista: Jeta juridike, Tribunë juridike, Avokatia, Mjekësia ligjore etj. Në të ekziston që prej 3 vitesh edhe biblioteka elektronike e aksesueshme nga studentët dhe pedagogët.</p>

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Biblioteka përditësohet sipas planifikimit të përgjegjësve të departamenteve, me qëllim mbështetjen e programit të studimit, të veprimtarisë kërkimore shkencore dhe për përgatitjen e tezës nga studentët. Në këtë pëditësim mbahen parasysh edhe kërkesat e stafit akademik dhe të studentëve. Përditësimi i bibliotekës mbështetet nga një fond financiar. Për këtë fond vjetor i dhënë nga KUB është rreth 450 mijë lekë.

Biblioteka funksionon sipas një orari të shpallur në ambjentet e saj dhe në faqen eeb të institucionit. Ajo është në dispozicion të stafit dhe studentëve nga dita e hënë në të premte në orarin 08:30-15:00 dhe 16:00-19:00 (Sipas faqes zyrtare të KUB). Në të ka hapësira të mjaftueshme për studim të pavarur.

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

KUB ka investuar dhe synon të investojë për sigurimin e kushteve sa më optimale infrastrukturore dhe mjetet didaktike me teknologjinë bashkëkohore për të mundësuar realizimin e mësimdhënies me një cilësi të lartë dhe rritjen e inkurajimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Mjediset e zhvillimit të mësimi janë të pajisura me videoprejektorë, laptopë, dërrasë dhe tabela, të përshtatshme për mësimdhënie dhe në përputhje me qëllimin e programit të studimit. Ato mirëmbahen dhe janë të disponueshme në çdo kohë.

Në KUB nuk ka laborator të posaçëm për këtë program studimi. Në të ekziston laborator i informatikës, me aparaturat dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e praktikave mësimore në këtë fushë. Në këtë laborator zhvillohen edhe praktika mësimore për lëndë/module të veçanta të programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" në fushën e informatizimit dhe inteligjencës kriminale për rritjen e efektivitetit të luftës për zbulimin dhe parandalimin e kriminalitetit. *Megjithatë, ngritja dhe funksionimi i një laborator modest të kriminalistikës do ta bënte më të lehtë përvetësimin e dijeve të kësaj shkence të aplikuar.*

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. GVJ, gjatë vizitës në Institucion, konstatoi se infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" është në

përputhje me standardet e kërkuara për këtë cikël studimi.

2. GVJ konstaton se Institucioni KUB i ofron studentëve një ambjent komod e të përshtatshëm për ndjekjen dhe zhvillimin e aktivitetit akademik, por edhe social.
3. Në funksion të rritjes së mëtejshme të cilësisë të këtij programi studimi, GVJ rekomandon ngritjen e një laboratorit kriminalistikmodest.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushëpërbushen.**

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

KUB, në drejtim të financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare funksionon konform legjislacionit në fuqi që parashikon dhe rregullon veprimtarinë e Arsimit të Lartë dhe të Shoqërive Tregtare. Institucioni, në mënyrë periodike, çdo vit, auditohet nga një ekspert kontabël i licensuar. Ai konsiderohet korrekt në zbatimin e legjislacionit në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Informacioni financiar i paraqitur në tabelat 8, 9 dhe 10 të Anekseve prezanton burimet e financimit dhe përdorimin i tyre. Menaxhimi i tyre kryhet nga “Bezo Consulting shpk” dhe “Instituti për Studime dhe Aplikime në Biznes” (ISAB) si entitete të të njëjtëve themelues edhe të IAL KUB, në bashkëpunim me njera tjetrën rakordojnë çështjet financiare dhe menaxhuese.

Në hartimin e treguesve ekonomiko-financiarë, KUB bashkëpunon me departamentet dhe njësitë kryesore të saj, duke marrë në konsideratë kërkesat e tyre për mbulimin dhe realizimin e veprimtarive mësimore.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafë, bare, residencat, etj)

Të dhënat e detajuara jepen në tabelën 8 të Anekseve.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

*Jelena*

*[Signature]*

Burimet financiare të KUB sigurohen kryesisht nga tarifat dhe pagesat e studentëve. Megjithatë investitorët financojnë sa herë që krijohet diferenë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, apo për investime për rritjen e standardeve të procesit mësimor. Burime të dyta, modeste, janë ato që krijohen nga zbatimi i projekteve të fituara për trajnime dhe kualifikime të profesionistëve në fushën ekonomike, siç është ai i Studimit Rajonal për Kontrabandimin e Duhanit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve shkon për koston e punës, kryesisht pagat e pedagogëve dhe qirasë së objektit. Trajtimi i stafit akademik në pikëpamje sasiore dhe cilësore ka sjellë rritjen e shpenzimeve. Pagesat e personelit akademik dhe administrativ, sipas kontratave të punës, kryhen në mënyrë korrekte. KUB trajton personelin akademik në pikëpamjen financiare sipas eksperiencës së tyre profesionale, gradave e titujve shkencorë dhe sipas udhëzimeve ligjore. KUB investon në përditësimin e bibliotekës me tituj të rinj, për përmirësimin e infrastrukturës mësimore, si dhe jep bursa për studentët e ekselencës apo në nevojë. KUB ka dëshmuar një gjendje financiare të mirë, të qëndrueshme dhe me kapacitete optimale për të zbatuar standardet që kërkohen për zhvillimin e Arsimit të Lartë. Të dhënat e detajuara jepen në tabelat 9 dhe 10 të Anekseve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>KUB në mënyrë periodike, çdo vit, auditohet nga një ekspert i jashtëm kontabël i licensuar, për situatën financiare të institucionit.</p> <p>Në raportin e auditimit pasqyrohet kontrolli dhe certifikimi i llogarive kontabël, pasqyrimi i gjendjes së librave financiarë, rezultatet sipas kërkesave të kontabilitetit, zbatimin e legjislacionit tregtar e tatimor.</p> <p>Në përfundim të procesit të auditimit përpilohet raporti mbi situatën financiare, me të cilin u njoh edhe GVJ.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një</p>	<p>KUB harton raporte vjetore për çdo vit kalendarik për situatën financiare, ku pasqyrohet aktiviteti financiar i tij.</p> <p>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programeve studimore, kryesisht nga tarifat e studentëve, por edhe nga të ardhura dytësore.</p>

qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	
---	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. GVJ konstaton se KUB ka një auditim periodik të përvitshëm (të jashtëm) të situatës financiare, i cili harton një raport financiar, ku parashikohen kostot e programit të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e kërkuara për zhvillimin me cilësi të procesit akademik.
2. GVJ konstaton se KUB investon në përmirësimin e infrastrukturës mësimore, në zhvillimin e aktivitetit kërkimor-shkencor, por edhe në aspektin social nëpërmjet dhënies së bursave studentëve në nevojë.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e KUB është krijuar dhe funksionon në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit. NJSBC ka rregulloren e vet të miratuar me vendim të Senatit. Në të shprehet qartë rëndësia e kësaj strukture, detyrat dhe kompetencat e saj në aktivitetin për sigurinë e cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike, kërkimore, kulturore e shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si dhe veprimtarisë së personelit administrativ të KUB.

NJSBC është njësi e përhershme dhe e pavarur, e cila synon vlerësimin e cilësisë së veprimtarisë akademike të KUB. Njësia përbëhet nga 7 anëtarë, (tabela 11 e Anekseve). Në përbërje të saj ka edhe student dhe është organ i përhershëm, me karakter këshillues dhe autonomi operative.

Gjatë takimit me anëtarët e NJSBC u konstatua se ata i kishin të qarta detyrat e tyre të shprehura në veprimtarinë konkrete në kontrollimin e cilësisë së procesit akademik.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët:
  - Sa studentë janë anketuar
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
  - Etj



Në fund të çdo semestri akademik (2 herë në vit) studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e performancës së pedagogëve, për çdo lëndë/modul. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde. Plotësimi i tyre kryhet në mënyrë konfidenciale. Ky anketim kryhet me të gjithë studentët, sipas viteve dhe grupeve. Përveç pyetësorëve manualë NJSBC e KUB ka zbatuar edhe metodën elektronike.(Tabelat 12 dhe 13 të Anekseve)

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve NJSBC nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog, si një indikator i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së tij. Këto vlerësime raportohen tek drejtuesit akademikë të KUB.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Veprimtaria e NJSBC reflekton në mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve në proces dhe të diplomuar, në intervistimin e pedagogëve apo të studentëve. Ky proces përfundon me përgatitjen e një raporti vjetor që analizon dhe krahason gjendjen aktuale me standardet shtetërorë të cilësisë që duhet të kenë institucionet e arsimit të lartë, i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektorit, për t'ju vënë dispozicion edhe Senatit. Bazuar në të dhënat dhe rekomandimet e këtij raporti nxirren konkluzione dhe detyra konkrete për përmirësimin e cilësisë të mësimdhënies. GVJ ,gjatë vizitës dhe takimit me anëtarë të NJSBC të KUB konstaton se, sipas rastit, rekomandimet e tyre merren në konsideratë nga drejtuesit e KUB, duke e ilustruar edhe me raste konkrete.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimi i kryer në institucionin KUB kryesisht konsiston në përmirësimin e programit të studimit me syllabuset konkrete si në aspektin e kërkesave të tregut të punës, ashtu edhe në përditësimin e tyre me ndryshimet ligjore dhe evoluimin e shkencës e të teknologjisë. Ky proces kryhet në mënyrë të organizuar në nivel departamenti, por edhe nga autonomia akademike e pedagogëve, si dhe përthithen edhe mendimet e studentëve nëpërmjet anketimeve apo pyetësorëve për programin e studimit dhe lëndëve/moduleve.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike konsistojnë në fushën e sigurimit të cilësië së mësimdhënies, në fushën e akreditimit, në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit, në fushëne auditimit dhe vlerësimeve të jashtme, në fushën e përditësimit të programeve dhe syllabusve, si dhe në fushën e përditësimit të anketimeve dhe intervistave në përshtatje me kërkesat bashkëkohore.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Vendim i Senatit Akademik Nr. 74, datë 26.07.2017
- Vendim i Senatit Akademik Nr. 47, datë 14.10.2016
- Vendim i Senatit Akademik Nr. 36, datë 16.10.2015

## Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> </ol>	<p>KUB ka pjesë të strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>KUB në mënyrë periodike vjetore bën vlerësimin e programeve nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve të studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimor, pasurimit dhe përditësimit të literaturës dhe teknikave të mësimdhënies, të dhëna të cilat i përfshin në vetëvlerësimin që bën për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>Aktiviteti monitorues i NJSBC për secilin proces të programit të studimit gjatë vitit akademik, raportohet me raport pranë Rektorit, Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit respektiv. Në raport janë nxjerrë rekomandime dhe lënë detyra për ndonjë parregullsi të mundshme në procesin mësimor, si dhe propozuar masa për ndryshime e korigjime për raste apo çështje konkrete.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojta, të drejtpërdrejta e të tërthorta, duke përfshirë: sondazhet, pjesëmarrjen në mbrojtjen e tezave, në realizimin e provimeve, ndjekjen e ecurisë së studentëve gjatë vitit akademik në realizimin e detyrave dhe të drejtave të tyre, opinionin e tyre, punësimin dhe rezultatet e marra nga studimi i tregut.</p> <p>Rezultatet e përfuara i bëhen të ditura stafit akademik, administrativ dhe studentëve.</p> <p>Të dhënat e nxjerra bëhen pjesë e Raportit Vjetor që Institucioni dërgon në MASR dhe ASCAL. Për vlerësimin e studentëve zbatohen metoda të tërthorta dhe kryesisht të drejtpërdrejta sipas përcaktimeve në syllabusin e lëndës, të cilat u bëhen të ditura studentëve që në fillim të zhvillimit të saj.</p>

<p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; h. Etj.</p>	
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>KUB përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësime periodike për cilësinë. Të dhënat e tyre bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe vjetore të NjsBC, por edhe e Raportit Vjetor që Institucioni përgatit në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Të dhënat e vlerësimit të brendshëm vihen në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve, si dhe në faqen e internetit.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>KUB nuk ka një analizë specifike për programin e studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”, por rezultatet e këtij programi studimi gjejnë pasqyrim në raportet që bën NjsBC.</p> <p>Politikat që synojnë përmirësimin e programit të studimit të ciklit të dytë të Fakultetit të Drejtësisë gjejnë pasqyrim në planin stregjik të zhvillimit të Institucionit.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një</p>	<p>KUB i është nështruar procesit të vlerësimit të jashtëm institucional dhe ka fituar akreditimin periodik me afat 4 vjet në vitin 2017, realizuar nga ASCAL dhe QAA.</p> <p>KUB zbaton instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, si: aprovimi, monitorimi dhe shqyrtimi periodik i programeve, syllabusave dhe tezave të provimit sipas kërkesave ligjore.</p> <p>Politika që harton KUB për procedurat e sigurimit të cilësisë dhe standardeve të programeve konsiston në sigurimin e cilësisë së stafit akademik dhe vlerësimit të studentëve.</p> <p>Institucioni shqyrton, miraton dhe mbikëqyr në mënyrë formale të herëpashershme programet e studimit në Departament, Dekanat dhe Senat.</p> <p>Ndërgjegjësimi i personelit të KUB për sigurimin e cilësisë për programet e ofruara lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka Institucioni: realizimi me cilësi të mirë i programeve, konkurrues dhe në përshtatje me kërkesat e tregut.</p>

strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

KUB mbështetet në strategjinë kombëtare të Arsimit të Lartë. Ajo ka edhe strategji të saj, si dhe në vijim, nëpërmjet takimeve periodike me ASCAL, e përditëson dhe përmirëson atë.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm Periodik, në takimin me anëtarët e NJSBC, me stafin akademik dhe me studentët, GVJ konkludon se:

1. NJSBC në KUB ka një status institucional të përcaktuar si një njësi permanente me anëtarë të brendshëm por edhe me studentë, çka krijon mundësinë për të operuar me efikasitet në përmirësimin e cilësisë.
2. Kjo njësi ka rregulloren mbi të cilën mbështetet e gjithë veprimtaria e saj me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer kontrollin, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësime në drejtim të cilësisë.
3. KUB garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron, sipas një metodologjie vlerësimi, me instrumente matëse dhe vlerësuese.
4. KUB publikon rregullisht informacion objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm. Kjo veprimtari bazohet në vizionin dhe objektivat e strategjisë së KUB.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**

### **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

#### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale”, zgjat 2 vite akademike. Në përfundim, mbasi plotësojnë numrin e krediteve – 120 ECTS dhe pas shlyerjes së provimit të gjuhës së huaj, studentët pajisen me diplomën Master i Shkencave në “E drejtë penale”. Objektivi kryesor i programit të studimit master i Shkencave në “E drejtë penale” është zgjerimi dhe thellimi i njohurive të studentëve të fituara në ciklin e parë të studimeve, krijimin e kompetencave

profesionale në dhënien e konsulencës dhe ekspertizës së thelluar juridike në fushën penale, si dhe për t'u punësuar e zhvilluar karrierë në sektoret publike e privat. Përmbajtja e programit të studimit, organizimi i tij në dy vite akademike, me nga dy semestra për çdo vit, plani mësimor me lëndët/modulet dhe kreditet respektive, syllabuset e lëndëve me format e mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve të studentëve, janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" është hapur me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011 dhe është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 545, datë 13.11.2012, në bazë të Vendimit Nr.394, dt.26.10.2012 të Këshillit të Akreditimit, si program studimi i ciklit të dytë Master i Shkencave në "E drejtë penale", pranë Fakultetit të Drejtësisë.

Qëllimi i programit të studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" është zgjerimi i njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" në fushën e drejtësisë me profilizim dhe dije të thelluara në fushën penale, për të krijuar tek studenti kompetenca profesionale e metodike në dhënien e konsulencës juridike në institucione publike e private, mundësi për të zhvilluar karrierë dhe punë shkencore të pavarur, nëpërmjet arritjes së objektivave kryesore sa vijon:

- a. Pajisjen e studentëve me njohuri të avancuara në fushën penale, në aspektin kombëtar e ndërkombëtar;
- b. Krijimin e kompetencave profesionale për vendime të pavarura me efekte juridike dhe sociale;
- c. Pajisjen e studentëve me njohuri e teknika për studim e punë të pavarur shkencore;
- d. Të aftësojë studentët me njohuritë bazë të komunikimit me shkrim dhe verbal, si dhe me çështje të etikës profesionale, si kërkesa të domosdoshme për karrierë të suksesshme.
- e. Të fitojnë njohuritë dhe aftësitë për punësim në sektorin publik dhe privat në fushën penale;
- f. T'u sigurojë studentëve njohuri themelore të specializuara për analizimin, kuptimin dhe zgjidhjen problemeve juridike në fushën penale;

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi i studimit Master i Shkencave në "E drejtë penale" me kohëzgjatje 2 vjeçare përmban 14 lëndë, ku përfshihet edhe praktika profesionale dhe teza e temës së diplomës. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Diplomë Master i Shkencave në "E drejtë penale" nëse plotësojnë 120 kredite sipas sistemit ECTS.

- 1 vit akademik ka: 30 javë mësimore në auditor, ose 60 kredite
- 1 Semestër ka: 15 javë mësimore në auditor, ose 30 kredite
- 1 ECTS: 25 orë mësimore të studentit
- 1 orë mësimore: 50'

Planin mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Planin mësimor paraqitet në tabelën 14 të Anekseve.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit (sipas RVB):

- Leksionet: rreth 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret: rreth 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit

- Praktika Profesionale: 10 orë në auditor dhe 70 orë punë e pavarur e studentit
- Punim Diplome: 10 orë në auditor

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Ndryshimet në planin mësimor krahasuar me programin e licensuar jepen në tabelën 15 të Anekseve.

Plani mësimor aktual 2017-2018 në krahasim me atë të vitit 2012-2013 ndryshon me 9 kredite më shumë për planin mësimor aktual. Ky ndryshim është i papërfillshëm dhe në respekt të standardeve të Ligjit të Arsimit të Lartë. Ky ndryshim është bërë si rezultat i riorganizimit të programit të studimit dhe për të shmangur përsëritjen e lëndëve që zhvillohen në Bachelor.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lëndët e parashikuara në planin mësimor zhvillohen nga pedagogë që plotësojnë kualifikimin akademik për këtë cikël studimi, por nga ana tjetër një pjesë e tyre janë personalitete shkencore e profesionale në fushën e tyre. Planet mësimore të lidhura me personelin akademik jepen në tabelat 16.1-16.5 të Anekseve.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Nga analiza e syllabuseve, në përmbajtje, specifikat, orët dhe kreditet ECTS, kërkesat ndaj studentëve, njohuritë nevojshme që transmetojnë tek studentët, rezulton se ato janë në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Nga viti akademik 2018-2019, do të jenë të përshatura edhe nga pikëpamja formale sipas VKM Nr.41, dt.24.01.2018- Shtojca 2, Programi i Lëndës. Në to gjen harmonizim të raportit të orëve në leksion, seminar dhe punën e pavarur të studentit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Ristrukturimi i planeve mësimore sipas Udhëzimit 15

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë është vazhdim i studimeve të ciklit të parë në drejtësi të vlerësuar në kredite. Formulimi i tij bazohet në Sistemin European të Transmetimit dhe Grumbullimit të Krediteve, dhe të përgatitë specialistë për tregun e punës. Programi i studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” përmban 120 ECTS, 60 ECTS në vit.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” bën të mundur, që nëpërmjet lëndëve të përgjithshme, profesionale, zgjedhore dhe formuese, së bashku me praktikën profesionale dhe tezën e diplomës, të krijojë specialistë me kompetenca të thelluara në fushën penale, konkurues në tregun e punës. <i>Megjithatë, në vitin e parë të këtij cikli studimi, në krahasim me lëndët e formimit të përgjithshëm, vihet re një % e ulët e lëndëve profesionale të fushës penale, çka ndikon negativisht në marrjen e njohurive të thella nga studentet në fushën penale, gjë që duhet të përmirësohet në të ardhmen.</i></p> <p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” garanton zgjerimin e njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve.</p> <p>Ky program studimi pajis studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike e praktike, të aftë për tu punësuar edhe në profesione të rregulluara me ligj.</p> <p>Zhvillimi i programit të studimit në fjalë pajis studentët me kompetenca profesionale dhe shkencore.</p> <p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” krijon baza të qëndrueshme njohurish për vazhdimin e studimeve më të thelluara, siç janë studimet e doktoraturës, si cikël i tretë.</p> <p>Ky program studimi ka objektiva të qarta profesionale, të justifikueshme dhe të arritshme, realizimi i të cilave bën të mundur formimin e studentëve me kualifikim të</p>

<p>tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>përshtatshëm për tregun e punës.</p>
<b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” është konceptuar në funksion të arritjes së objektivave që kërkohen të fitohen në një cikël të dytë studimi, me të gjitha tiparet e një programi studimi shkencor.</p> <p>Metodat e vlerësimit të verifikuara edhe gjatë vizitës në Institucion vlerësohen bashkëkohore. Të gjitha metodatat e vlerësimit të studentëve janë ta parashikuara në syllabuset e çdo lënde, të cilat u bëhen të ditura studentëve që në fillim të zhvillimit të saj. Ato janë sistematike dhe progresive.</p>
<b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disa vjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” mbështetet në përvojën më të mirë disa vjeçare kombëtare, rajonale dhe europiane, duke bashkëpunuar me institucione dhe shkolla në nivel evropian, me qëllim që studenti të jetë i gatshëm për tregun e punës edhe jashtë vendit.</p> <p>Ky program studimi zhvillohet sipas sistemit të Bolonjës. Kurrikula e tij është e krahasueshme me programet e studimeve europiane. Bazuar në lëndët, përbajtjen e tyre, kreditet dhe metodatat e vlerësimit të studentëve, mobiliteti dhe transferimi i studimeve realizohet me lehtësi.</p> <p>Objektivat e përgjithshme të këtij programi studimi përkojnë me legjislacionin tonë dhe të BE-së për Arsimin e Lartë. Në këtë kontekst, p.sh., zhvillohen lëndët: E drejta penale e avancuar dhe E drejta penale ndërkombëtare.</p>
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve</p>	<p>Krahas studimeve të thelluara në fushën penale, në këtë program studimi përfshihet</p>



<p>të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>edhe realizimi i praktikave profesionale dhe i kërkimit shkencor. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe realizimi i leksioneve të hapura.</p> <p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” është hartuar sipas profilit dhe strategjisë për zhvillimin e tij. Qëndrueshmëria e zhvillimit të këtij programi studimi është tregues i qartë i këtij profilizimi të Arsimit të Lartë.</p> <p>Personeli akademik i KUB angazhohet në bashkëpunim me institucione të tjera për aktivitete e pjsëmarrje në konferenca shkencore, në prezantim punimesh shkencore e shkëmbim përvoja akademike në funksion të realizimit të programit të studimit me nivel të lartë dhe literaturë të përditësuar.</p> <p>Gërshetimi i stafit akademik të brendshëm me atë të jashtëm që janë me veprimtari të spikatur shkencore në fushat e tyre, janë tregues i synimit të realizimit të objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”</p>
<p><b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>KUB nuk zhvillon programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional.</p>
<p><b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> </ol>	<p>Zhvillim ekonomik i një vendi nuk mund të jetë i sukseshëm pa rend dhe siguri, pa zbuluar dhe parandaluar kriminalitetin, detyra që, përpos të tjerash, realizohen me specialistë të aftë në fushën penale. Pikërisht këtë objektiv të strategjisë të zhvillimit ekonomik të vendit, ka patur hartimi dhe zhvillimi i programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale”.</p> <p>Zhvillimi i këtij programi studimi kryhet sipas nevojave të tregut. Tregues i kësaj kërkese është së mbi 80% e studentëve që e kanë përfunduar atë janë të punësuar. (<i>Aneksi Nr.30, Raporti i punësimit</i>).</p> <p>Studentët e diplomuar në këtë program studimi mund të punësohen në shërbimin dhe studio</p>

<p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>ligjore të avokaturës, mund të punësohen në shërbimet dhe organet e policisë gjyqësore, mund të punësohen në profesionet tjera të fushës, të rregulluara me ligj, por mund të punësohen edhe në institucione publike e private.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është i përafërt me atë të regjistruar në programe të ngjashme të institucioneve simotra.</p>
---	---

**Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” që ofron institucioni KUB është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet për Arsimin e Lartë, si dhe ruan e garanton realizimin e tij me cilësi.</p> <p>Ky program studimi ruan vlerat e kulturës kombëtare. Kjo mishërohet në planin mësimor, në syllabuset me tipologjinë e temave përbërëse, si dhe me literaturën e detyruar dhe ndihmëse të pasqyruar në to.</p>
--	--

**Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>KUB ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” të organizuar në lëndë/module të vlerësuara në kredite, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, duke respektuar dhe ruajtur vlerat dhe traditën kombëtare dhe sipas sistemit europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve. Ky program studimi realizohet me 120 kredite ECTS në dy vite akademike, të shpërnadarë në 14 lëndë, përfshi edhe praktikën profesionale me 10 kredite dhe tezën e diplomës me 30 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të</p>	<p>N/A</p>

<p>integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Çdo student i regjistruar në KUB ka informacion paraprak për përmbajtjen e programit të studimit, klasifikimin e lëndëve dhe syllabuset e tyre nëpërmjet faqes elektronike ëeb të institucionit, por edhe nga takimet direkte të stafit akademik me studentët. Hollësi të mejshme për çdo lëndë jepen nga pedagogu respektiv në fillimin e semestrit.</p> <p>Syllabuset e lëndëve ekzistojnë në formë elektronike dhe në formë të printuar në arkivin (zyrën e kancelarit) të shkollës. Secili syllabus përmban informacion të përgjithshëm dhe të veçantë për lëndën respektive.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Institucioni ka një program diplomimi të pasyqruar në rregulloren e këtij programi studimi. Pas përfundimit të programit të studimit studenti pajiset me diplomën përkatëse të shoqëruar me suplementin e saj, sipas formës të miratuar në senat dhe udhëzimeve tëMAS. Diploma e lëshuar regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” teza e diplomës është parashikuar të vlerësohet me 30 kredite. Për përgatitjen e saj jepen udhëzimet nga udhëheqësi i saj si në aspektin formal ashtu edhe në atë të përmbajtjes.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është i organizuar mirë, me personel të angazhuar, i studiuar dhe projektuar për të siguruar një produkt të mirë, studentë të përgatitur në aspektin teorik e shkencor dhe cilësi profesionale në fushën penale për tregun vendas dhe më gjerë.</li> <li>2. Përmbajtja e programit të studimit konsiston në kërkesat e tregut të punës; klasifikimi i lëndëve, përmbajtja e tyre dhe puna kërkimore e mësimore që zhvillohet janë garanci për</li> </ol>	

realizimin e objektivave të programit të studimit dhe sigurimin e një specialisti konkurues.

3. Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në “E drejtë penale” zhvillohet në një afat kohor 2 vjeçar, përrmban 14 lëndë, praktikën profesionale dhe tezën e diplomës, duke plotësuar 120 kredite sipas sistemit ECTS. Me përrmbushjen e tyre studentët pajisen me Diplomën Master Shkencor në “E drejtë penale”.
4. Në vitin e parë të programit të studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” numri i lëndëve të fushës penale duhet të zenë një % më të madhe krahasuar me ato të formimit të përgjithshëm.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushëpërrmbushen kryesisht.**

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

KUB është organizuar dhe funksionon mbi një paketë të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, të cilat janë të aksesueshme dhe që në mënyrë formale i komunikohen të gjithë stafit akademik. Në veprimtarinë e KUB organizimi dhe zhvillimi i procesit mësimor përbën shtyllën kryesore rreth së cilës mbështeten dhe zhvillohen edhe aktivitete të tjera kërkimore – shkencore për arritjen e objektivave të programit të studimit.

Bashkëveprimi dhe kombinimi i moshës dhe përvojës së pedagogëve, veprimtaria akademike dhe profesionale e tyre janë garanci për zhvillimin e mësimdhënies me kreativitet dhe metoda bashkëkohore dhe teknologjinë e kohës. Komponentët mësimorë të programit të studimit, përpara vitit 2018 janë në mbështetje dhe zbatim të udhëzimeve të MASR, ndërsa nga viti 2018 e në viim janë sipas udhëzimeve të MASR dhe VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, si: mësimet në auditor, studimi individual, praktika profesionale, përgatitja për provime dhe mikrotezën; ndërsa mënyrat kryesore të mësimdhënies në auditor janë: teorike, ku përrfshihen leksionet, konferencat shkencore e diskutime teorike, dhe praktike, ku përrfshihen seminarët, ese, detyrat e kursit etj.

Metodologjia e mësimdhënies përbën një çështje kryesore të programit të studimit, në të cilën përrfshihet jo vetëm lektimi, por edhe metoda interaktive, mendimi kritik, pjesëmarrje e zhvillim debati të studentëve për çështje konkrete të zbatimit të teorisë e ligjit në praktikë, duke e kthyer kështu pedagogun edhe në një lloj moderatori.

Në kontekstin e lirisë akademike pedagogu zgjedh metodat që do të përdorë për zhvillimin e mësimt. Në KUB procesi mësimdhënës zhvillohet kryesisht në auditor. *Meqënëse programi i studimit Master i Shkencave në “E drejtë penale” është shumë aplikativ, rekomandohet që metoda*

dhe forma të mësimdhënies të përfshijnë edhe praktika konkrete dhe vizita në laboratorë, studio ligjore, gjykatë etj.

KUB, stafi akademik, organizon dhe monitoron kontrollin e vazhdueshëm të studentëve gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të studimit. Ky proces vlerësimi kryhet nëpërmjet instrumenteve të vlerësimit, të parashikuar në syllabuset e çdo lënde, të cilat jo vetëm që i bëhen të ditur studentit në fillim të zhvillimit të saj, por zbatimi me korrektësi dhe cilësi i tyre nga stafi akademik e administrativ, bën të mundur rritjen e cilësisë së të nxënies në këtë institucion.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

- Leksione
- Seminare/Ushtrime
- Praktikë profesionale
- Diploma

Të dhënat jepen në tabelën 17 të Anekseve.

Format e kontrollit të njohurive

Vlerësimi i njohurive të arritura të studentit bëhet sipas sistemeve bashkëkohore europiane. Secili pedagog, duke u bazuar në syllabusin e lëndës, vlerëson shpërndarjen e vlerësimit në ushtrime, laboratorë, detyra kursi etj. Ai kryhet në dy faza: Faza e parë, vlerësimi i studentit përfshin: pjesëmarrjen aktive në leksione 10%, plotësimin e detyrave të kursit dhe testime gjatë vitit 30%, ndërsa faza e dytë, provimi përfundimtar i lëndës i vlerësuar në 60%, metoda të cilat plotësojnë shkallën 100% për vlerësim maksimal. Përqindjet përfundimtare ndahen në segmente për vlerësim me notë. Notat janë nga 4 deri në 10. (Tabela 18 e Anekseve)

Pas vlerësimit dhe shpalljes së notës, nëse studenti ka pretendime paraqet ankesë brenda tre ditëve. Vlerësimi me notë i studentëve është proces i kontrolluar dhe i siguar. Ato ruhen me korrektësi e siguri në sekretarinë mësimore.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Përpos pjesëmarrjes në përgatitjen e eseve, detyra kursi, etj. studentët aktivizohen edhe në aktivitete të Institucionit, si: konferenca shkencore, aktivitete sociale etj. KUB ka organizuar mirë edhe jetën studentore nëpërmjet ZMSKK- Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimi dhe Karrierës, njësi që asiston dhe ndjek ecurinë e studimeve, gjatë zhvillimit, por edhe mbas mbarimit të tyre, suksesin dhe vështirësitë e tyre në treg, përgatitja dhe pjesëmarrje në konferenca të ndryshme etj. (Tabela 21 e Anekseve)

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika,

punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në KUB bëhet konform rregullave të përcaktuara nga MASR dhe rregullave të brendshme për këtë qëllim. Qasja e parë e një kandidati për të aplikuar të vazhdojë studimet në këtë institucion është faqja e internetit dhe formulari i plotësuar. Më tej paraqiten dokumentet, si: diploma universitare Bachelor, transkriptim i notave Bachelor, diplomën e shkollës së mesme, etj. Cilësia e studentëve në hyrje të këtij programi studimi është e kënaqshme, me notë mesatare mbi 7, e cila jo vetëm që ruhet gjatë gjithë ciklit të programit të studimit, por në diplomimin e studentëve ajo shkon rreth 8. Kohëzgjatja e studimeve i kalon 2 vitet, rreth 3 vite, çka tregon për korrektësi dhe kërkesë të stafit akademik në vlerësimin e studentëve. Rreth 80% e studentëve të diplomuar janë të punësuar. Ata mirëinformohen për gjithçka që lidhet me programin e studimit dhe evenimente të rëndësishme akademike të KUB.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

#### Procedurat e pranimit të studentëve

Kandidatët duhet të kenë dhe plotësojnë dokumentet: diplomë e shkollës së mesme, diplomë e studimeve të ciklit të parë, Bachelor, së bashku me certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, ose fitojnë një diplomë tjetër jashtë vendit të ekuivalentuar nga MASR, si dhe ata persona që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë ose të tretë, zotërojnë dëshmi të gjuhës angleze – niveli B1, pranojnë pagimin e tarifës semestrale ose vjetore, si dhe kritere të tjera të parashikuara në aktet ligjore e nën ligjore në fuqi.

#### Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Studentët në hyrje janë me mesatare mbi 7, ndërsa në dalje me notë mesatare rreth 8. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 19 të Anekseve.

#### Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Sipas të dhënave në RVB (fq. 56), në vitin akademik 17-18 janë 17 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 7.6 Në vitin akademik 16-17 janë 7 studentë të regjistruar për herë parë, me notë mesatare 7.3. Në vitin akademik 15-16 janë 9 studentë të regjistruar për herë të parë, me mesatare 7.5. Në vitin akademik 14-15 janë 5 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 7.6. Në vitin akademik 13-14 janë 5 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 7.3. Në vitin akademik 12-13 janë 11 studentë të regjistruar për herë të parë, me notë mesatare 7.4. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 19 të Anekseve.

#### Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Sipas të dhënave në RVB (fq. 56), në vitin akademik 12-13 janë 31 studentë të diplomuar, me notë mesatare 8.21. Në vitin akademik 13-14, janë 11 studentë të diplomuar, me notë mesatare 7.44. Në vitin akademik 14-15 është 1 student i diplomuar, me notë mesatare 8.25. Në vitin akademik 15-16 nuk ka studentë të diplomuar. Në vitin akademik 16-17 janë 8 studentë të diplomuar, me notë mesatare 7.51. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 20 të Anekseve.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

KUB ofron mobilitetin e studentëve midis institucioneve të arsimit të lartë brenda vendit. Bazuar në ligjin e Arsimit të Lartë, statutin dhe Rregulloren e vet KUB ofron mundësinë e transferimit të studentëve në të gjitha vitet e programit të studimit, duke bërë dhe respektuar të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e kërkuar nga MASR. Gjatë vizitës në institucion u verifikuan praktika të kësaj fushe dhe u gjetën korrekte.

- Të dhëna për punësimin e studentëve

Punësimi i studentëve të diplomuar në programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është rreth 90%, nga të cilët 53% në përputhje me diplomën. Të dhëna të detajuara jepen në tabelën 20 të Anekseve.

- Numri total të diplomuarve

Numri total i të diplomuarve është 51, pa përfshirë vitin akademik 2017-2018 që është në proces.

- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të punësuar në përputhje me diplomën është 22 ose 53%.

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i studentëve të punësuar jo në përputhje me diplomën është 19 ose 37%.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:

- Statistikat e punësimit 2017-2018
- Paketa udhëzuese për zhvillimin e praktikave mësimore
- Marrëveshje bashkëpunimi

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Në këtë program studimi janë regjistruar studentë të cilët kanë plotësuar kriteret që përbëjnë paketa ligjore për këtë cikël studimi. Të gjithë studentët e pranuar në këtë program studimi zotërojnë diplomën Bachelor me 180 ECTS.
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Pranimi i studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” është kryer në përputhje me normat ligjore e nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit	Studentët e pranuar kanë plotësuar kriteret e

<p>të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>përcaktuara në Rregulloren e Programit të Institucionit.</p> <p>Për studentët e pranuar në këtë program studimi është kusht dëshmia e gjuhës angleze sipas udhëzimeve të dhëna nga MASR.</p> <p>Institucioni dëshmon se teston herë pas here vlerësimin e politikave të pranimit të studentëve në këtë program studimi dhe në vartësi me strategjinë afatgjatë të institucionit harton e përditëson plane për ndryshimin e mundshëm të kriterëve të pranimit, duke respektuar dispozitat ligjore.</p>
<p><b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>KUB u jep studentëve informacion për punësim që në fillim, gjatë zhvillimit të programit të studimit, si dhe mbas diplomimit. Për këtë qëllim shërben bashkëpunimi që KUB kame institucione publike e biznese private, nga të cilat informacionin dhe mundësitë për punësim ua përcjell studentëve.</p> <p>Studentëve u jepet informacion i detajuar mbi akreditimin e institucionit dhe të programit të studimit nëpërmjet faqes elektronike, broshurave dhe takimeve direkte, apo në faqenëb të KUB. Ky informacion shoqëron edhe kontratën e regjistrimit të studentit për performancën e institucionit.</p> <p>Në KUB funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit dhe Karrierës, e cila në mënyrë aktive informon dhe këshillon studentët për zhvillimin e lekioneve të hapura, trajnimeve ekstrasikulare, intership-eve në rang Kolegji dhe më gjerë, për aktivitete sportive e sociale etj.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në</p>	<p>KUB disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar. Ky informacion përshkruhet edhe në broshura që u jepen studentëve për programin e studimit dhe studentët ndër vite.</p>



<p>programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>KUB disponon statistika për ecurinë dhe dinamikën e studentëve të Programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, të cilat raportohen në mënyrë periodike në MASR. Të dhënat e studentëve të diplomuar mbahen në regjistrin bazë të studentëve.</p> <p>Gjithashtu, KUB disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të këtij programi studimi. Në regjistrin bazë pasqyrohen notat për secilin student.</p>
<p><b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>KUB, nëpërmjet Zyrës së marrdhënieve me publikun dhe Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, mban një bazë të dhënash për studentët e punësuar pas përfundimit të tij por edhe për vendet konkrete se ku janë të punësuar.</p> <p>KUB nuk disponon një bazë të dhënash për studentët që mund të vazhdojnë ciklet e tjera të studimit, çka mbetet si detyrë për ta krijuar dhe ndjekur edhe këtë bazë të dhënash.</p>
<p><b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Informacionet për programin e studimit, afatin e provimeve, afatin e përfundimit të programit të studimit janë publike. Gjithashtu, përveç broshurave, sekretaria mësimore dhe stafi akademik informojnë vazhdimisht studentët. Studentëve u vihet në dispozicion dokumenti i performancës akademike të institucionit, i cili nënshkruhet nga student si pjesë e kontratës së regjistrimit.</p> <p>Informacioni për rezultatet e studentëve, sipas formave të kontrollit të njoftuara që në fillim të procesit mësimor, bëhet i vazhdueshëm nga pedagogu përgjegjës dhe sekretaria mësimore.</p> <p>Përgjegjësi i lëndës/modulit për çdo formë periodike kontrolli të parashikuar në syllabus, informon studentët për rezultatet e arritura.</p>
<p><b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	

**Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Në KUB funksionon ZSKK e cila u ofron informacion dhe ndihmon studentët në zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që mund të dalin gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Ky informacion konsiston në zhvillimin e leksioneve të hapura, në zhvillimin e konferencave shkencore të institucionit, në aktivitete sociale sportive, por edhe për tregun e punës, për të paraqitur aplikime.

Studentët e KUB mbështeten dhe informohen nga ZSKK, krahas këshillimit për karrierën edhe për probleme më specifike siç është psh. zhvillimi i praktikës profesionale, përzgjedhja e institucionit për ta kryer atë, udhëzime për zhvillimin e saj etj.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Pranimet në KUB për programin e studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale” kryhen sipas procedurave dhe rregullave ligjore në fuqi. Studentëve u jepet informacion që ka të bëjë me performancën, akreditimin e institucionit dhe programit të studimit, si dhe mundësitë për punësim.
2. KUB disponon të dhëna, statistika dhe të gjithë informacionin zyrtar për studentët në lidhje me procesin mësimor dhe për punësimin e tyre, duke respektuar konfidencialitetin dhe privatësinë e të dhënave. Në këtë aspekt mbetet që në të ardhmen institucioni të informohet edhe për arsimimin e mëtejshëm të studentëve mbas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve.
3. Raportet pedagog student janë në nivele të mira, korrekte dhe pa probleme.
4. Në KUB, sipas kalendarit të procesit mësimor, studentët marrin vazhdimisht informacion për rezultatet e vlerësimit, të cilat janë transparente.
5. Pranë KUB funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit dhe Karrierës, e cila, në bashkëpunim me struktura të tjera të Fakultetit dhe senatit studentor, informon studentët për aspekte të procesit mësimor, por edhe sportiv e social.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Veprimtaria kërkimore shkencore e KUB organizohet në një plan të detajuar të pëfshirë në politikën e zhvillimit dhe planit strategjik të tij, si domosdoshmëri për realizimin cilësor të programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”. Ajo synon:

- rritjen e performancës kërkimore shkencore të stafit akademik me kërkesat e kohës;
- reflektimin e kësaj veprimtarie në auditor duke e zhvilluar atë në mënyrë interaktive me studentët;
- krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione homologe e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit;
- pjesëmarrja dhe promovimi i vlerave kërkimore shkencore të stafit akademik në aktivitete kërkimore, në rradhë të parë në ato të organizuara nga institucioni, por edhe jashtë tij.

KUB publikon revistën periodike “Scientific Journal of Professional Studies” me ISSN 4412-5865, me shkrime kryesisht të stafit akademik të Institucionit, por edhe nga studiues jashtë saj.

KUB merr pjesë si partner në projekte të ndryshme, siç është: “*Rritja e pjesëmarrjes së femrave në biznes*”. Institucioni ka organizuar një sërë konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. (Aneksi 41- Puna shkencore e KUB).

Institucioni zhvillon edhe konferenca studentore me pjesëmarrje të studentëve të KUB, të vendit dhe të rajonit si: Konferenca e parë studentore kombëtare me temë: “*Young European Leadership*” më dt. 17.06.2016; Konferenca e dytë studentore kombëtare me temë: “*Hapja e negociatave me BE sfidë dhe mundësi për të rinjtë shqiptarë*” më dt.21.05.2018.

Aktiviteti individual shkencor i stafit akademik të institucionit KUB evidentohet në planformularë në fillim të vitit akademik dhe realizimi i tij po në planformularë në fund të vitit akademik.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 22 e Aneksëve)

Sipas aktiviteteve kërkimore shkencore rezulton se ato plotësojnë standardet e një institucioni të lartë arsimor, si në pikëpamje sasiore, ashtu edhe në atë cilësore. Për çdo vit akademik janë zhvilluar gati 2 konferenca shkencore, pak a shumë në të njëjtin raport midis atyre kombëtare me ato ndërkombëtare. Disa prej të cilave janë si vijon:

- Konferenca I Ndërkombëtare Shkencore, me temë “*Zhvillimet bashkëkohore, sfidat dhe perspektivat*”, që u zhvillua më 14 qershor 2013. Të gjitha punimet shkencore të konferencës u botuan në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN 978-9928-123-59-6.
- Konferenca II Ndërkombëtare Shkencore, me temë “*Ndryshimi global - impakti ekonomik dhe ligjor*” që u zhvillua më 29 prill 2014. Të gjitha punimet shkencore të konferencës u botuan në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978-9928-123-80-0.
- Konferenca III Ndërkombëtare Shkencore me temë “*Sustainable Development and Life Quality Improvement in Albania toward EU Integration process*”. Të gjitha punimet shkencore të konferencës u botuan në revistën Proceedings Book të konferencës me ISBN: 978-9928-187-25-3.
- Konferenca IV Ndërkombëtare me temë “*Reforms in economy and Justice, conditions and challenge for Albania European Perspective*”, zhvilluar me 22 04.2016. Të gjitha materialet e punimit janë botuar në Proceedings Book të konferencës me ISBN 978-9928-130-35-8.
- Konferenca I Kombëtare Shkencore me temë “*Pushteti Gjyqësor dhe Integrimi European i Shqipërisë*”, zhvilluar me date 04.06.2015.

- Konferenca II Kombëtare Shkencore me temë “Mbrotjtja e mjedisit dhe sfidat e menaxhimit”, zhvilluar me dt 29.04.2016.
- Konferenca III Kombëtare Shkencore me temë “Zhvillimet ekonomike dhe juridike në Shqipëri në kuadrin e negocimit për anëtarësim në BE”, zhvilluar më 21.04.2017.
- Konferenca IV Kombëtare Shkencore me temë “Përgjegjësia sociale e korporatës si program zhvillimi për biznesin”, zhvilluar më datë 22.12.2017.
- Konferenca V Kombëtare Shkencore me temë “Dinamika e të drejtës ekonomike shqiptare nga periudha e Skënderbeut deri në legjislacionin bashkëkohor”, zhvilluar më datë 25.05.2018.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Pjesëtarë të stafit akademik janë autorë tekstesh mësimore, monografi shkencore apo cikël leksionesh të shkruara, si dhe botojnë artikuj shkencorë në revista periodike sipas fushës. KUB publikon revistën periodike “Scientific Journal of Professional Studies” me ISSN 2412-5865.</p> <p>Angazhimi dhe veprimtaria kërkimore shkencore e personelit akademik rrit cilësinë e mësimdhënies por edhe ndihmon në zhvillimin e shkencës shqiptare dhe më gjerë.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>KUB nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Forma më e zhvilluar e kualifikimit të mëtejshëm të personelit akademik është ajo e leksioneve të hapura. Për të rritur më tej kualifikimin e tyre, organizimi nga institucioni i programeve specifike në fushën pedagogjike e didaktike janë të vlefshme dhe të rekomandueshme.</p> <p>Personeli akademik është mbështetur nga</p>

	<p>institucioni për kualifikim të mëtejshëm brenda dhe jashtë vendit. Tregues i kësaj mbështetje është fakti se 5 pedagogë personel i brendshëm në proces doktorature e kanë përfunduar atë, 2 prej të cilëve e kanë mbrojtur në Greqi.</p>
<p><b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni harton raportin vjetor të aktiviteteve kërkimore shkencore të zhvilluara dhe realizuar gjatë vitit. (<i>Aneksi 38- Puna shkencore e KUB</i>).</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për veprimtarinë botuese e kërkimore shkencore të personelit akademik, një pjesë e këtyre botimeve gjenden edhe në bibliotekë.</p> <p>Projektet në të cilat merr pjesë institucioni janë publike në faqen e internetit të KUB.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Personeli akademik angazhohet në veprimtari kërkimore shkencore në funksion të zhvillimit të programit të studimit Master i Shkencave në “E Drejtë Penale”, të misionit dhe objektivave të tij.</li> <li>2. Institucioni mbështet kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik. 5 prej anëtarëve të stafit akademik efektiv kanë marrë gradën shkencore Dr.</li> <li>3. Institucioni mbështet veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik dhe disponon të dhëna për këtë veprimtari.</li> <li>4. KUB ka zhvilluar në vijimësi konferenca shkencore, kombëtare e ndërkombëtare.</li> <li>5. Rekomandohet që institucioni të organizojë veprimtari kualifikuese me personelin akademik në fushën pedagogjike e didaktike.</li> </ol> <p><b>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.</b></p>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e

sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga IAL, konstatohet se KUB ka vendosur marrëdhënie me shumë institucione arsimore brenda vendit por edhe me ato të rajonit. Kjo veprimtari është në zbatim të një prej prioriteteve të planit strategjik të zhvillimit të institucionit, me qëllim rritjen e ofertës akademike dhe vlerën e diplomës edhe jashtë vendit.

Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar i KUB reflektohet në mënyrën e organizimit të aktiviteteve akademike, në shkëmbimin e eksperiencës së mësimdhënies midis studentëve dhe stafit akademik, në mobilitetin e studentëve, në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore, si dhe në fushën e botimeve të përbashkëta, me synim sigurimin e shërbimeve më cilësore për studentët dhe personelin akademik.

Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të KUB me institucione të tjera arsimore, të vendit e të huaja, janë materializuar aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si: trajnime për studentët, për pedagogët, për shkëmbime pedagogësh, shkëmbime studentësh në kuadër të programit ERASMUS+, leksione të hapura etj. Marrëveshjet e nënshkruara të bashkëpunimit të KUB me institucione të tjera arsimore kërkimore dhe të biznesit jepen në tabelat 23 dhe 24 të Anekseve.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Numri i institucioneve arsimore, të subjekteve të biznesit, të subjekteve publike apo private me të cilat KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi është i konsiderueshëm. Ndërkaq ndjekja dhe realizimi i pikave të këtyre marrëveshjeve ngelet të plotësohen dhe realizohen më mirë në praktikë. Të dhënat e detajuara mbi bashkëpunimin e KUB me institucione kombëtare e ndërkombëtare jepen në tabelën 23 të Anekseve.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

KUB ka realizuar bashkëpunim me subjekte të rëndësishme të biznesit, por edhe me institucione të tjera të rëndësishme publike dhe private, të cilat shërbejnë jo vetëm për shkëmbim eksperience, për kryerjen e praktikave profesionale, por edhe për punësimin e mundshëm të studentëve. Të dhënat e detajuara jepen në tabelën 24 të Anekseve.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>KUB dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm të sferës publike apo private që mundësojnë integrimin e aspekteve teorike e shkencore me ato praktike, si: Avokati i Popullit, Zyra e Avokatisë Kombëtare, Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, studio të ndryshme ligjore avokatie e kontabël, kompani sigurimesh, etj., të cilat, gjithashtu, mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>
--	--

**Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Gjatë vizitës në KUB u vu re një frymë bashkëpunimi, shkëmbimi informacioni dhe mirëkuptimi midis anëtarëve të stafit akademik në nivel departamenti ashtu edhe në atë institucional.</p> <p>Në institucion ka ndarje të detyrave dhe përgjegjësisë. Fryma e bashkëpunimit nxit dhe inkurajon nisma për projekte të përbashkëta në fushën e aktiviteteve shkencore, por edhe sociale e marrëdhënie të mira ndërpersonale.</p>
--	--

**Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	<p>KUB disponon një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione të larta arsimore të vendit, rajonit dhe më gjerë.</p> <p>KUB ka një rrjet të gjerë institucionesh brenda vendit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi dhe zbatim të programit të studimit që ofron. Ky rrjet është dinamik dhe i përditësuar.</p> <p>KUB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me komunitetin e biznesit dhe institucione publike e private për organizimin e konferencave apo trajnimeve të përbashkëta.</p>
---	---

<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni analizon dhe harton një raport analitik mbi ecurinë e marrëdhënieve kontraktore për të kuptuar përfitimin e arritur, si dhe përmirësimet e mundshme, në funksion të realizimit të programit të studimit Master i Shkencave “E Drejtë Penale”. Konstatohet se realizimi i tyre ka qënë i mirë. Nga zhvillimi i tyre institucioni nuk ka përfitime financiare.</p>
---	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. KUB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm të sferës publike apo

private që mundësojnë integrimin e aspekteve teorike e shkencore me ato praktike dhe qëmundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.

2. KUB ka organizuar marrëdhënie të mira me aktorë të biznesit, brenda dhe jashtë vendit për kryerjen e praktikave të studentëve, në trajnime e shkëmbim eksperience të pedagogëve, në leksione të hapura, etj.
3. Marrëdhëniet e mira midis personelit akademik dhe atij institucional, vlerësimi i përgjegjësive dhe fryma e bashkëpunimit midis tyre, por edhe me studentët garantojnë realizimin e standardeve të kërkuara si institucion i arsimit të lartë.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludon se standardet për këtë fushë përmbushen.**



